



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**V E N D I M**

**PËR**

**PËR VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË KANDIDATIT NGA LISTA SHUMEMËRORE PËR ANËTARË NË KËSHILLIN E BASHKISË SARANDË, Z. MYZAFER FERRIK SHAMETI, NË ZBATIM TË LIGJIT NR.138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE".**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 20.03.2019, me pjesëmarrjen e:

|         |           |            |
|---------|-----------|------------|
| Klement | ZGURI -   | Kryetar    |
| Denar   | BIBA -    | Zv/Kryetar |
| Bledar  | SKËNDERI- | Anëtar     |
| Edlira  | JORGAQI-  | Anëtare    |
| Rezarta | BITRI-    | Anëtare    |

Shqyrtoi çështjen me,

**OBJEKT:** Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit nga lista shumëmemërore për Anëtar në Këshillin e Bashkisë Sarandë, z. Myzafer Ferrik Shameti, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

**BAZË LIGJORE:** Neni 23, pika 1, germa a, i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Neni 11, i ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; Kreu V, i Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

**Nr . 89 i Vendimit Data 20.03.2019 e vendimit Ora 10:30 e vendimit**



Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit nga lista shumëmemërore për anëtar në Këshillin e Bashkisë Sarandë, z. Myzafer Ferrik Shameti, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

## VËREN

Këshilli i Bashkisë Sarandë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në këshill, vakancë kjo e krijuar si pasojë e dorëheqjes nga mandati si Anëtar në Këshillin Bashkiak, të njërit prej Këshilltarëve.

Referuar nenit 11 të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave kryhet në përputhje me këtë ligj, për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore të subjektit politik Partia Lëvizja e Legalitetit, ka plotësuar e depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, të kandidatit për anëtarë në Këshillin e Bashkisë Sarandë, **z. Myzafer Ferrik Shameti**, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Sarandë, të subjektit politik Partia Lëvizja e Legalitetit, ka deklaruar si vijon:

✓ në pikën 1 të formularit të vetëdeklarimit (A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?), ka deklaruar se:

- Me vendimin nr.543/45 datë 04.04.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, është dënuar për veprën penale "Ndërtim i Paligjshëm", parashikuar nga neni 199/a, paragrafi i dytë Kodi Penal, dhe ndaj tij është vendosur masa e dënimit 8 (tetë) muaj burgim, në provë për 24 muaj;

- Me vendimin nr.23-2016-699(99) DT datë 05.04.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, është dënuar për veprën penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyes dhe i municionit", parashikuar nga neni 278, paragrafi i dytë, Kodi Penal, dhe ndaj tij është vendosur masa e dënimit 80.000 (tetëdhjetë mijë) lekë gjobë.

✓ në pikën 4 të formularit të vetëdeklarimit (A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligj zbatuese, për kryerjen e ndonjë vepre penale?), ka deklaruar se është ndaluar nga:

---

**Nr . 89 i Vendimit Data 20.03.2019 e vendimit Ora 10:30 e vendimit**



Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit nga lista shumemërore për anëtar në Këshillin e Bashkisë Sarandë, z. Myzafer Ferrik Shameti, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Sarandë në periudhën 16.09.2013–04.04.2014, për veprën penale “Ndërtim i Paligjshëm”, është deklaruar fajtor dhe ndaj tij është vendosur pezullim i dënimit, amnistuar;
- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Sarandë, në periudhën 12.12.2014-09.01.2015, për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyesë dhe i municionit”, dhe ndaj tij është vendosur, ndryshim i masës së sigurimit në detyrim paraqitje dhe përfunim të dënimit me gjobë.
- ✓ në pikën 5 të formularit të vetëdeklarimit (A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi ose jo?) ka deklaruar se është caktuar masë e sigurisë personale:
  - Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore;
  - Arrest në burg.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, pika 2, germa b dhe pikës 3, germa c, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 328 prot., datë 13.02.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 327 prot., datë 13.02.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, për kandidatin për anëtar në Këshillin e Bashkisë Sarandë, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Në përgjigje të shkresës nr. 327/1 prot., datë 26.02.2019 zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar në këshillin bashkiak, sipas të cilës rezultoi se z. Myzafer Ferrik Shameti, është i dënuar.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk ka kthyer ende përgjigje kërkesës tonë.

Në bazë të Vërtetimit të Gjendjes Gjyqësore nr. 11 prot., datë 20.02.2019, z. Myzafer Ferrik Shameti rezultoi se:

- me vendimin nr. 543/45 datë 04.04.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, deklarohet fajtor për veprën penale “Ndërtim të Paligjshëm” bazuar në nenin 199/A të Kodit Penal dhe dënohet me 1 (një) vit burgim.

Në zbatim të nenit 406 të K.Pr.P dënohet me 8 (tetë) muaj burgim.

Në aplikim të nenit 59 të K.P pezullohet ekzekutimi i vendimit me burgim duke e vënë në provë për një periudhë 24 (njëzetë e katër) muaj me kusht.

---

**Nr . 89 i Vendimit Data 20.03.2019 e vendimit Ora 10:30 e vendimit**



Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit nga lista shumëmemërore për anëtar në Këshillin e Bashkisë Sarandë, z. Myzafer Ferrik Shameti, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

- Me vendimin nr.99, datë 05.04.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, deklarohet fajtor për veprën penale "Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe të municionit", të parashikuar nga neni 278/2 të Kodit Penal dhe neni 406 K.Pr.P, dënohet me 80.000 (tetëdhjetë mijë) lekë gjobë.

Referuar gurmës ç, të pikës 1 të nenit 2, të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ndalimet për kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit zbatohen ndaj personave të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë për kryerjen me dashje të një krimi që nuk përfshihet në shkronjat "a" dhe "b" të kësaj pike, dhe kur janë dënuar me jo më pak se 6 muaj burgim.

Ligji nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", në nenin 4 të tij parashikon dhe periudhën gjatë të cilës zbatohen dispozitat e këtij ligji për ndalimin, kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit, në varësi të llojit të veprës penale të deklaruar/ dënuar.

Sipas nenit 4 të ligjit të sipërcituar

.....

4. Për personat që parashikohen nga shkronja "ç", e pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi zgjat nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formë së prerë, deri në momentin e rehabilitimit, sipas nenit 69 të Kodit Penal.

.....

9. Ulja e masës së dënimit për shkak gjykimi të shkurtuar apo procedure të ngjashme me të që passjell uljen e dënimit, amnistia, depenalizimi, falja, pezullimi i dënimit, lirimi i parakohshëm me kusht apo çdo shkurtim i dënimit, në përputhje me ligjin, nuk ndikojnë në zbatimin e këtij ligji dhe nuk përlogariten në funksion të shkurtimit të afatit të dënimit, me qëllim shkurtimin e periudhës së ndalimeve të parashikuara nga ky ligj. Ky ligj nuk zbatohet për dënime të dhëna për dispozita që janë shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese pas dhënies së dënimit përkatës, si dispozita në kundërshtim me Kushtetutën në fuqi në momentin e dënimit.

Referuar vërtetimit të gjendjes gjyqësore në lidhje me veprën penale, "Ndërtim të Paligjshëm", bazuar në nenin 199/a të Kodit Penal, z. Myzafer Shameti është dënuar me 1 (një) vit burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, e dënon me 8 (tetë) muaj burgim. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal e pezullon dënimin me burgim duke e vënë në provë për një periudhë 24 (njëzetë e katër) muaj me kusht.

Bazuar në pikën 9 të nenit 4, ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ulja e masës së dënimit në 8 (tetë) muaj

---

**Nr . 89 i Vendimit Data 20.03.2019 e vendimit Ora 10:30 e vendimit**



Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit nga lista shumemërore për anëtar në Këshillin e Bashkisë Sarandë, z. Myzafer Ferrik Shameti, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

burgim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, për shkak të gjykimit të shkurtuar, pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë, apo amnistia nuk ndikojnë në zbatimin e këtij ligji dhe nuk përlogariten në funksion të shkurtimit të afatit të dënimit, me qëllim shkurtimin e periudhës së ndalimeve të parashikuara nga ky ligj.

Referuar nenit 33, 42 dhe 47 të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, njoftoi me telefon dhe nga platformat e komunikimit social si palë në këtë shqyrtim administrativ, z. Myzafer Ferrik Shameti, për të dhënë mendime dhe shpjegime për faktet dhe rrethanat e çështjes.

**1.** Sipas Pikës 13 Kreu V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", nëse ekzistojnë të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve, të parashikuara nga neni 2 i ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, verifikon nëse ato përfshihen brenda periudhës së ndalimit të përcaktuar në nenin 4 të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike".

Referuar nenit 4, pika 4, të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike", periudha e ndalimit për ushtrimin e funksionit për personat e dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 2, pika 1, gërma ç, e këtij ligji, ndalimi zgjat nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë deri në momentin e rehabilitimit sipas nenit 69 të Kodit Penal.

Referuar dispozitivit të vendimit nr. 543/45, datë 04.04.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, për deklarimin fajtor për veprën penale "Ndërtim të paligjshëm" dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burgim bazuar në nenin 199/A të Kodit Penal;

referuar pikës 9 të nenit 4 të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", sipas të cilës ulja e masës së dënimit për shkak të gjykimit të shkurtuar, depenalizimi, amnistia nuk përbën shkak dhe nuk përlogariten në funksion të shkurtimit të afatit të dënimit, me qëllim shkurtimin e periudhës së ndalimeve të parashikuara nga ky ligj;

referuar nenit 69 të Kodit Penal, gërma "b" sipas së cilës quhen të padënuar "ata që janë dënuar me burgim për një kohë nga 6 (gjashtë) muaj gjer në 5 (pesë) vjet dhe që gjatë pesë vjetëve nga dita e vuajtjes së dënimit nuk kanë kryer vepër tjetër penale";

---

**Nr . 89 i Vendimit    Data    20.03.2019 e vendimit    Ora 10:30 e vendimit**



Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit nga lista shumemërore për anëtar në Këshillin e Bashkisë Sarandë, z. Myzafer Ferrik Shameti, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

referuar masës së dënimit dhe datës së vendimit nr. 543/45, datë 04.04.2014, periudha e ndalimit të ushtrimit të funksionit, në aplikim të nenit 69 të Kodit Penal dhe pikës 4 dhe 9 të nenit 4 të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", zgjat për një periudhë kohore prej 5 (pesë) vitesh deri në rehabilitimin e tij.

Në bazë nenit 4 të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për personat që parashikohen nga shkronja "ç", të pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të funksionit zgjat deri në momentin e rehabilitimit sipas nenit 69 të Kodit Penal, 5 vjet nga momenti i vuajtjes së dënimit me burg dhe që gjatë pesë vjetëve nga dita e vuajtjes së dënimit nuk kanë kryer veprë tjetër penale. Sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë, dhe sipas përgjigjes së zyrës së gjendjes gjyqësore që rezultoi i dënuar, z. Myzafer Ferrik Shameti, kandidat i listës shumëmemërore i subjektit Partia Lëvizja e Legalitetit, për anëtarë të Këshillit të Bashkisë Sarandë, është brenda periudhës së ndalimit të ushtrimit të funksionit.

Neni 11, pika 2 e ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", parashikon se:

Për kandidatët e listave shumëmemërore, për të cilët kryhet verifikimi, sipas pikës 1, të këtij neni, kur verifikohen kushtet e moszgjedhshmërisë, sipas këtij ligji, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, shpall faktin e moszgjedhshmërisë së personit përkatës dhe procedon me kandidatin vijues, në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin Zgjedhor.

Për sa më sipër Komisioni Qendror i Zgjedhjeve referuar nenit 14 dhe nenit 11, pika 2, e Ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", shpall faktin se z. Myzafer Ferrik Shameti, është në kushtet e moszgjedhshmërisë në funksionin e anëtarit të Këshillit të Bashkisë Sarandë.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, germa a, i Ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; nenin 11, i ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; Kreu V, i Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara

---

**Nr . 89 i Vendimit Data 20.03.2019 e vendimit Ora 10:30 e vendimit**



Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit nga lista shumëmemërore për anëtar në Këshillin e Bashkisë Sarandë, z. Myzafer Ferrik Shameti, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

**VENDOSI:**

1. Të shpall moszgjedhshmërinë si anëtar në Këshillin e Bashkisë Sarandë, të z. Myzafer Ferrik Shameti.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

|                |                  |                   |
|----------------|------------------|-------------------|
| <b>Klement</b> | <b>ZGURI -</b>   | <b>Kryetar</b>    |
| <b>Denar</b>   | <b>BIBA -</b>    | <b>Zv/Kryetar</b> |
| <b>Bledar</b>  | <b>SKËNDERI-</b> | <b>Anëtar</b>     |
| <b>Edlira</b>  | <b>JORGAQI-</b>  | <b>Anëtare</b>    |
| <b>Rezarta</b> | <b>BITRI-</b>    | <b>Anëtare</b>    |

---

**Nr . 89 i Vendimit Data 20.03.2019 e vendimit Ora 10:30 e vendimit**



Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit nga lista shumemërore për anëtar në Këshillin e Bashkisë Sarandë, z. Myzafer Ferrik Shameti, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".